



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 946 Prot.

Tiranë, më 29.03 2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 44 dt. 29.03 2023

**“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË “SHKENCAT E ReHABILITIMIT
(FIZIOTERAPI)” NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË REHABILITIMIT”**

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 2, pika b, 33 paragrafi 3, 38 pika d të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 paragrafi 2 pika b, nenin 20 pika e të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, në vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës nr.61, datë 23.04.2021 “Për miratimin e Rregullore të programit të studimit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit”, si dhe mbështetur në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit nr.905 prot., datë 24.03.2023 “Propozim mbi ndryshimet në Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të parë Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)” në FSHR, mbështetur në vendimin nr.8, datë 28.03.2023 të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, si dhe Vendimin nr. 33 datë 29.03.2022 të rektoratit, Senati Akademik me Vendim Qarkullues

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Programit të Ciklit të Parë të Studimeve Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit (Fizioterapi)” në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit (bashkëlidhur).
2. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA

